




REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/
REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA SHTIME/ OPSTINA-STIMLJE/ MUNICIPALITY OF SHTIME
ZYRA E KRYETARIT/KANCELARIJA PREDSEDNIKA/MAYOR'S OFFICE



24/06/2024

Nr. i Protokollit: 02/ 692

Procesverbal nga dëgjimi publik me banorët e fshatit Muzeqinë

E enjte, më 18 qershor 2024

Kohëzgjatja e takimit: 18:30 – 19:40

Vendi i takimit: SHF "Lasgush Poradeci"

Pjesëmarrës në takim ishin: Kryesuesi i Kuvendit - Adnan Ademi, Drejtori i Drejtorisë për Planifikim Urban, Kadastër dhe Gjeodezi - Grejtalb Emini dhe Drejtori i Drejtorisë për Shërbime Publike – Bardhyl Rushiti, Asamblesitët- Besnik Seferi, Gëzim Haxhiu dhe Sanie Sadiku.

Rendi i ditës:

1. Korniza Afatmesme Buxhetore 2025-2027

Kryesuesi i Kuvendit, Adnan Ademi : Përshëndetje për të gjithë dhe faleminderit që sot ju keni përgjigjë ftesës që të jeni në këtë takim. Takim ka të bëjë me Kornizën Afatmesme Buxhetore për vitin 2025-2027, dëgjimet publike i kemi filluar që tre ditë dhe këtu jemi sot në fshatin e njëmbëdhjet që po marrim pjesë dhe do të vazhdojmë edhe në fshatrat tjerë. Këtu jemi sot të flasim për vitin 2025, sepse planifikimet i bëjmë për një vit dhe jo më shumë dhe 2026, 2027 mbeti vetëm projeksione. Buxheti në vitin 2024 ka qenë afër 10 milion euro, ndërsa është fat i mirë që në vitin 2025 ka një rritje prej 900 mij euro dhe kështoj buxheti në komunën e Shtimes për vitin 2025 do të jetë afër 11 milion euro, domethënë është vetëm buxheti lokal pa i llogaritur grandet dhe projektet të cilat vijnë nga niveli qendror. Ju e dini që ne përveç buxhetit në Komunën e Shtimes, kemi sjellë edhe projekte të shumta në numër, është fat i mirë që kemi gjetur mbështetje të ministrave të ndryshëm po ashtu edhe të Kryeministrit për projektet e mëdha sepse Shtimja është lënë pas nga pushtetet e më hershme.

Në Komunën e Shtimes kanë ardhur shumë investime, është në procedurë entit special, Komuna e re, QKMF -ja e re, është bërë tranziti po bëhen unazat e qytetit, kemi bërë edhe rrugë të tjera që tani nuk po i përmendim të gjitha.

Buxheti ndahet në disa kategori dhe kategoria që më së shumti merr buxhet në Komunën e Shtimes është pjesa e pagave dhe mëditjeve, kategoria tjetër janë subvencionet të cilat kemi paraparë që për vitin 2025 të kenë një rritje nga 350 mijë sa i kemi këtë vit të shkojnë në 500 mijë, pjesa tjetër e buxhetit është mallra dhe shërbime si dhe shpenzime komunale.

Sot jemi këtu bashkarisht me Drejtorët që të marrim kërkesat e juaja sa i përket vitit 2025, cilat janë prioritetet e fshatit tuaj.

Kërkesat e banorëve të fshatit :

- Halil Lami: Në rrugën “Maliq Hoxha”, kemi probleme me energjinë elektrike, është shumë e dobët kemi nevojë për nja trafo pasi që edhe paisjet në shtëpi po prishen si shkak i energjisë së dobët.
- Behar Sejda: Tek pjesa e varrezave duhet të bëhet një parking po ashtu rruga për tek varrezat duhet të zgjerohet pasi që është tepër e ngusht.
Kemi hapësirë diku afër 20 ari në mes të fshatit, është mirë që ajo pjesë të bëhet park për fshatinë ton pasi që kemi nevojë.
Pritore e autobusit të vendoset.
Kemi problem me kompaninë “Pastërtia”, kalon kohë e gjatë dhe nuk vijnë që të marrin mbeturinat.
Trotuari të vazhdohet nga kyqja tek rruga “Fejzullahu”, deri tek shkolla.
- Muhamet Fazliu: Në rrugën “Fejzullahu”, kemi nevojë për një zgjidhje të bëhet sa i përketë pjesës së trotuarit kur fëmijët shkojnë në shkollë.
Po ashtu kemi problem me lumin pasi që shtrati është ngushtuar dhe është i mbushur me pem e mbeturina, kemi nevojë për pastrim sepse gjatë verës në nuk mund të qëndrojmë nga aroma e keqe.
- Bejtush Sejda: Të bëhet një park në mes të fshatit pasi që ne kemi nevoj për ecje, fëmijët të luajnë.
- Shqiprim Hyseni: Të vendoset një pengesë në rrugën “Fejzullahu”.
- Gerona Lami: Në një segment në rrugën “Lasgush Poradeci”, nuk ka rrym, ujësjellës e as kanalizim.

Procesmbajtës,
Gentiana Mehmeti





REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/
REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA-SHTIME/OPŠTINA-ŠTIMLJE/MUNICIPALITY OF SHTIME

Lista e pjesëmarrësve në dëgjimin publik në Muzeqinë

Date: 18/06/2024

Nr	Emri dhe Mbiemri	Nenshkrimi
1	Gerona Lami	
2	Halil Lami	
3	Muhamet Qerifi ORQO+	
4	BEKIM SHKRIPI	
5	BEDA BRAHIMI	
6	Bejtosh Sejda	
7	Behna Sejda	
8	SHKRIPI HUSEINI	
9	Adem Krasniqi	
10		
11		
12		
13		
14		
15		
16		
17		